



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Duke u bazuar në Rregulloren Nr. 2001/19 (Dega Ekzekutive e Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisë në Kosovë), Rregulloren Nr. 2001/36 Mbi Shërbimin Civil të Kosovës, Urdhëresën Administrative Nr. 2003/2, Udhëzimin Administrativ Nr. MSHP/DASHC 2003/1 mbi procedurën e rekrutimit, Ministria e Drejtësisë shpallë këtë:

K O N K U R S

III: PROKURORIA E SHTETIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

6. Pozita: Përkthyes Shqip - Anglisht dhe anasjelltas - 1 (një vende pune) - rishpallje

Referenca: MD/PSHRK/18 - 08 - 06 - 2010

Paga: 251 € Koeficienti: 7

I përgjigjet: Administratorit

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Bën përkthime simultane ose të drejtpërdrejta sipas nevojës, në seancat dëgjimore ose gjatë hetimit.
- Përkthen materiale, shkresa, lëndë dhe akte individuale në prokurori që i përpilojnë prokurorët nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas,
- Përgjegjës për ruajtjen e konfidencialitetin e dokumenteve dhe shkresave të cilat i përkthen, duke mos komentuar për të njëjtat në punë dhe jashtë vendit të punës,
- Kryen punë tjera, varësisht nga nevojat e organit e sipas kërkesës së administratorit në kuadër të punëve administrative në prokurori.

Kualifikimi, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Diplomë Universiteti nga Fakulteti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze,
- Një (1) vit eksperiencë pune si përkthyes,
- Njohuri themelore të sistemit ligjor dhe terminologjisë juridike,
- Certifikatë të përkthyesit për dygjuhësi Shqip - Serbisht dhe anasjelltas grupi i III të për përpilim të shkresave dhe akteve,
- Njohja e kompjuterit me aplikim të programeve (Word, Excell),
- Sjellje të mira ndër personale me palët dhe stafin.

Periudha e kontratës:

Punësimi bëhet me kontratë, kontrata e punës lidhet për periudhë kohore prej 1 viti, me 3 muaj punë provuese dhe me mundësi të vazhdimit të kontratës.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Ministria e Drejtësisë / Divizioni i Burimeve Njerëzore, **Rruga « Ish-Ndërtesa e Rilindjes» kati i 7 - të, Zyra Nr. 723, Prishtinë, Kosovë;**

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore në, tel: 038 / 213 860 ose 038 - 200 182 86), prej orës 08:00 - 16:00.

Konkursi ngel i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në njërin nga gazetatat ditore, duke filluar nga data **18.08.2010** gjer më datën **01.09.2010** që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrin brenda 4 ditësh, aplikacionet që arrin pas këtij afati dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Kandidatët të cilën hynë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen në intervistë përmes telefonit dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para komisionit intervistues.